



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1197

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Valdrini sh.p.k, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA GLLOGOC në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i rrugës Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës, Drenas me numër të prokurimit 611-25-9865-5-2-1, me 28.01.2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE Valdrini sh.p.k me nr. 2025/1197, e datës 04.12.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i rrugës Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës, Drenas me numër të prokurimit 611-25-9865-5-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KOMUNA GLLOGOC, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Ndertimi i rrugës Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës, Drenas me numër të prokurimit 611-25-9865-5-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Valdrini Sh.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.10.2025 KOMUNA GLLOGOC, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Ndertimi i rrugës Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës, Drenas me numër të prokurimit 611-25-9865-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €.

Me 14.11.2025 KOMUNA GLLOGOC, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE M Shala FA Sh.P.K.

Me 19.11.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 24.11.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04.12.2025, OE Security Code, ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1197, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Valdrini Sh.P.K, janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore – sa i përket Formularit të Letrës Standarde për Tenderues të ELIMINUAR (a; b)

E kundërshtojmë në tërësi vendimin e AK-së lidhur me letrën standarde për tenderues të papërgjegjshëm, për faktin se arsyetimi i AK-së sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pabazuar dhe në shkelje të kërkesave të përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT, si dhe në shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues Komuna Gllogoc, me datë 14.11.2025, ka dërguar vendimin dhe letrën standarde në të cilën ka propozuar për shpërblim me kontratë operatorin ekonomik M. SHALA FA Sh.p.k., me çmimin total të ofertës 99,207.50 €.

Ne, si GOE: “Valdrini” Sh.p.k. & Benita Company Sh.p.k., kemi ofruar çmimin total të ofertës 80,000.00 € dhe jemi renditur ofertuesi i parë me çmimin më të ulët.

E kundërshtojmë në tërësi vendimin e AK-së lidhur me eliminimin tonë nga gara, kinse për arsye të cilat janë të paqëndrueshme, dhe do t'i kundërshtojmë këto pretendime të AK-së me fakte dhe argumente, pasi na eliminon nga gara kinse për arsye si vijon:

1. Në DT është paraqitur kërkesa për afatin e ekzekutimit të punimeve që është 30 ditë gjatë vitit 2025; në planin dinamik që keni hartuar nuk është cekur periudha e përfundimit të punimeve, vetëm periudha prej 30 ditë, pa përcaktuar shpërndarjen kohore, pra vitin për të cilin është hartuar plani dinamik për fillimin dhe përfundimin e projektit.

2. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejt janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit, duke përfshirë edhe stafin profesional. Ju keni paraqitur një listë për stafin që do të kyçet në projekt dhe nuk keni përfshirë menaxherin, inxhinierin Nuhi Shabani, inxhinier konstruktiv, të cilin e keni caktuar si projektmenaxher dhe i keni bashkëngjitur dokumentacionin në DT. Andaj kriteri nuk përputhet me kërkesat në DT dhe NJK.

3. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, pika 14. Tek kriteri për makinë për spërkatje të emulsionit, sipas marrëveshjes të paraqitur me kompaninë ABC, është paraqitur një librezë kamioni special; në librezë nuk shkruan për integrimin në kamion të makinës për spërkatje të emulsionit dhe disa fotografi që nuk plotësojnë kriterin e kërkuar, makinë për spërkatje të emulsionit mobile. Andaj nuk i përmbush kriteret e DT dhe NJK.

4. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, pika 6. Cilindër me xhamba, vibrator dhe shtytës max. 700 kg. Është paraqitur një kontratë me kompaninë N.N. “Shkëmbi”, i cili në marrëveshje me kompaninë Muhamet Mucici B.I. ka paraqitur BOMAG BW 75E me numër serik 140119547 dhe peshë 485 kg, i cili sipas kërkesave nuk është cilindër me xhamba dhe shifra i përket një cilindri me rrotulla të rrafshëta; i njëjti nuk është vibrator dhe shtytës. Gjithashtu pesha e mjetit nuk është paraqitur në faturë dhe NJK mes N.N. “Shkëmbi” dhe “Muhamet Mucici B.I.”, andaj ky mjet nuk përputhet me kërkesat në DT.

5. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, pika 13. Traktor 4x4 me lugë ngarkuese dhe lopata rrafshuese. Ju keni paraqitur një marrëveshje me kompaninë N.N. “Shkëmbi” dhe e njëjta ka një faturë me kompaninë “Vëllezërit Ramadani” për blerje të një eskavatori–traktori, ku nuk figuron siç është cekur në faturë 4x4 me lugë ngarkuese dhe lopata rrafshuese. Gjithashtu, sipas të dhënave në faturë, është paraqitur një traktor i thjeshtë, ndërsa i njëjti në fotografinë që ju i keni bashkëngjitur faturës është paraqitur skip. Andaj nuk i përmbush kriteret e DT dhe NJK.

6. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, pika 7. Makineri sheshuese dhe nivelizuese – grejder me ripera dhe ndalesa të zhavorit min. 16 ton max. 18 ton. Keni paraqitur një grejder në marrëveshje me kompaninë “Kthella” Sh.p.k. me peshë 16 ton, mirëpo nuk është përcaktuar me ripera dhe ndalesa të zhavorit, dhe për të njëjtin në dokumentacion nuk është specifikuar një markë apo një dokument që e vërteton se mjeti përputhet me të dhënat e paraqitura në dosjen e tenderit. Andaj, bazuar në fotografitë e paraqitura nga ju, nuk i përkasin mjetit që keni prezantuar dhe nuk i përmbush kriteret e DT dhe NJK.

7. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, pika 15. Çift semafora mobil me dirigjues digjital. Ju keni paraqitur një marrëveshje me “Ndërtimi” Sh.p.k.; i njëjti ka në pronësi, sipas faturës së blerjes, semafora me bateri, ndërkohë në dudit doganor nuk është paraqitur asnjë e dhënë mbi biznesin se kujt i përket ky dokument, dhe i njëjti nuk i ka semaforat sipas kërkesës në DT, çift semafora mobil me dirigjues digjital. Gjithashtu, në marrëveshje me kompaninë “Alko – Impex Construction” janë paraqitur semafora sinjalistik dhe nuk janë çift me dirigjues digjital, andaj nuk përputhen me kërkesën e AK-së.

8. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, pika 10. Kamion kiper me vinç për transport dhe sistem për ruajtjen e nxehtësisë së asfaltit, pesha maksimale e ngarkesës së lejuar min. 8 – max. 9 ton. Ju keni paraqitur në marrëveshje me kompaninë Kabashi N.N. një kamion kiper me vinç me peshë 8.29 ton dhe nuk ka sistem për ruajtjen e nxehtësisë së asfaltit. I njëjti nuk përmbush kriteret e DT dhe NJK.

9. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, pika 3. Eskavator me dy kova rrafshuese dhe ngarkuese, pesha min. 15 ton max. 16 ton. Ju keni paraqitur në marrëveshje me kompaninë N.N. Kabashi një eskavator të tipit Komatsu vetëm me lugë ngarkuese. Gjithashtu, në marrëveshjen me kompaninë “Fidani L” Sh.p.k. keni paraqitur një eskavator i cili nuk i plotëson kërkesat sipas DT dhe NJK.

10. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, pika 16. Pompë zhytëse për largimin e ujërave me fuqi 7.5–11 kW. Ju keni paraqitur në listën e pajisjeve të “Valdrini” Sh.p.k. një pompë 7.5 kW, ndërsa e njëjta sipas dokumentacionit nuk i përmbush kërkesat e DT dhe NJK; në faturë nuk është e shkruar fuqia, ndërsa bazuar në të dhënat e pompës që keni paraqitur, fuqia e kësaj pompe është shumë herë më e vogël. Gjithashtu, pompa në marrëveshje me kompaninë “Gurëbardhi” nuk e ka të specifikuar fuqinë e pompës, andaj nuk i plotëson kërkesat e AK-së në DT dhe NJK.

11. Kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, pika 18. Kompresor ajri me sistem elektrik dhe agregat min. 320 volt. Në listën për pajisje për projekt keni paraqitur kompresor ajri me sistem elektrik në pronësi të “Valdrini” Sh.p.k., ndërsa i njëjti nuk figuron fare në listën e pajisjeve të kompanisë “Valdrini” Sh.p.k.; ndërsa keni paraqitur në listë një agregat ndaras tek kompania në konzorcium “Benita”.

PËRGJIGJET TONA:

Sipas kërkesës së AK-së, në DT ka qenë: Afatet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës; Plani dinamik 30 ditë.

Në ofertën tonë, në ditën e ofertimit, ne kemi dorëzuar planin dinamik, në të cilin kemi deklaruar se Grupi i OE: Valdrini Sh.p.k & Benita Company Sh.p.k këtë projekt mund ta realizojë për 30 ditë. Ky plan dinamik është bërë sipas kërkesës së AK-së në DT.

Pretendimi i dytë nga AK se kinse nuk kemi paraqitur menaxherin e projektit në listë të stafit, Nuri Shabani, nuk është i vërtetë, sepse ne kemi paraqitur menaxherin Nuri Shabani në listën e stafit të partnerit të konzorciumit Benita Company Sh.p.k, fajlli nr. 10: Lista e stafit ORG, Benita, Vendimi MK.

Pretendimi i tretë nga AK se kinse pajisja makinë për spërkatjen e emulsionit mobile nuk e plotëson kriterin nuk është i vërtetë, sepse ne kemi paraqitur një kamion special i cili shërben për shpërndarjen e emulsionit dhe e kryen të njëjtin funksion sipas kërkesës së AK-së. Si dëshmi kemi ofruar foto dhe po ashtu kamioni është makinë mobile.

Pretendimi i katërt nga AK se kinse pajisja cilindër me xhamba, vibrator dhe shtyes max. 700 kg, nga dëshmitë e prezantuara (faturë blerjeje, kontratë blerjeje dhe foto e tiketës) nuk e plotëson kriterin, nuk është i vërtetë sepse i plotëson kriteret sipas kërkesës së AK-së. Po ashtu, AK nëse ka pasur dilema për këtë pajisje është dashur të kërkojë sqarime shtesë, sepse për këtë pajisje ne e kemi edhe DUD-in doganor, i cili dëshmon edhe më shumë që kjo pajisje është sipas kërkesës së AK-së. Si dëshmi shtesë po ju bashkëngjisim edhe DUD-in doganor të kësaj pajisjeje të prezantuar me faturë, pagesë dhe kontratë blerjeje.

Pretendimi i pestë nga AK se kinse pajisja Traktor 4x4 me lugë ngarkuese dhe lopatë rrafshuese nuk është sipas kërkesës së AK-së në DT, nuk është e vërtetë sepse ne kemi ofruar një traktor 4x4 me lugë ngarkuese dhe lopatë rrafshuese. Për këtë, nëse AK ka pasur dilema, është dashur të

kërkojë sqarime shtesë, sepse pajisja e kërkuar në DT është e njëjtë me pajisjen e ofruar nga ne. Po ashtu, për këtë pajisje po ju bashkëngjisim dëshmi shtesë që tregojnë se e plotëson kërkesën e AK-së në DT.

Pretendimi i gjashtë nga AK se kinse pajisja makinë sheshuese niveluese (greder) me ripera dhe ndalesa zhavorri 16–18 ton nuk e plotëson kriterin sipas kërkesës së AK-së në DT nuk është i vërtetë, sepse ne kemi ofruar një greder me ripera dhe ndalesa zhavorri me peshë 16,000 kg (16 ton), i marrë me marrëveshje me qira nga Kthella Sh.p.k, i cili është i dëshmuar me librezë qarkullimi valide dhe me foto që dëshmojnë se është sipas kërkesës së AK-së në DT.

Pretendimi i shtatë nga AK se kinse nuk kemi plotësuar kriterin për pajisjen çift semafora mobil me dirigjues digjital nuk është i vërtetë, sepse ne e kemi plotësuar këtë kriter pasi kemi marrë me marrëveshje me qira nga OE: Ndërtimi ING Sh.p.k, të cilat dëshmojnë me faturë blerjeje, ku dëshmohet se janë 2 copë sinjalizues elektrik të trafikut (2 semafora me bateri) dhe me DUD-in doganor të tyre. Po ashtu, kemi paraqitur edhe 2 semafora (çift) me marrëveshje me qira nga Alko Impex Construction, të dëshmuara me faturë blerjeje.

Pretendimi i tetë nga AK se kinse nuk kemi plotësuar kriterin për pajisjen kamion kiper me vinç me peshë bartëse 8–9 ton me sistem për ruajtje të nxehtësisë nuk është i vërtetë, sepse ne kemi ofruar pajisjen me marrëveshje me qira nga Kabashi Projektim Ndërtim Sh.p.k sipas kërkesës së AK-së, dhe nëse AK ka pasur dilema është dashur të kërkojë sqarime shtesë për këtë pajisje.

Pretendimi i nëntë nga AK se kinse nuk kemi plotësuar kërkesën për pajisjen eskavator me dy kova rrafshuese dhe ngarkuese 15–16 ton nuk është i vërtetë, sepse ne kemi ofruar një eskavator me marrëveshje me qira nga OE: Kabashi Projektim Ndërtim Sh.p.k, i cili është dëshmuar me DUD doganor (eskavator me 1+3 lugë ngarkuese) dhe po ashtu me foto që dëshmojnë se ka një kovë për ngarkim dhe një lopatë rrafshuese para. Po ashtu, ky eskavator ka edhe 2 kova të tjera shtesë, të cilat ndërrohen sipas nevojës. Po ashtu, kemi ofruar edhe një eskavator tjetër shtesë i cili e plotëson këtë kriter.

Pretendimi i dhjetë nga AK se kinse nuk kemi plotësuar kriterin për pajisjen pompe zhytëse për largimin e ujërave me kapacitet 7.5–11 kW nuk është i vërtetë, sepse ne kemi dorëzuar një pompë zhytëse Atlas Copco WEDA 7.5 kW sipas faturës së blerjes, e cila është në pronësi të liderit të grupit Valdrini Sh.p.k dhe e plotëson kërkesën e AK-së në DT, sepse kërkesa ka qenë kapaciteti 7.5 deri 11 kW dhe kjo pajisje e jona e plotëson këtë kriter, pasi në faturën e pronësisë është cekur kapaciteti i pompës 7.5 kW.

Pretendimi i njëmbëdhjetë nga AK se kinse nuk kemi plotësuar kriterin për pajisjen kompresor ajri me sistem elektrik dhe agregat min. 320 volt nuk është i vërtetë, sepse ne kemi paraqitur një kompresor ajri me sistem elektrik i cili është në pronësi të liderit të grupit Valdrini Sh.p.k, dhe një agregat min. 320 volt që është në pronësi të partnerit të grupit Benita Company Sh.p.k, të cilët e plotësojnë kërkesën e AK-së në DT. Këtë e kemi dëshmuar në Listën e pajisjeve, fajlli 27 – Aneksi për pajisje sipas kërkesave të AK-së.

PRETENDIM: AK ka bërë shkelje duke dëmtuar buxhetin komunal në vlerë 19,207.50 €, duke rekomanduar për kontratë OE M. SHALA FA Sh.p.k, i cili ka ofruar çmimin më të lartë në mesin e ofertuesve, duke na tejkualuar neve si GOE: Valdrini Sh.p.k & Benita Company Sh.p.k, operatorë të përgjegjshëm me çmimin më të lirë të ofruar në ofertën tonë 80,000.00 €.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Autoriteti Kontraktues ka analizuar pretendimet e juaja ankimore dhe ka vlerësuar se pretendimet e paraqitura janë të pabazuara, pasi edhe në vetë kërkesën për ri-shqyrtim nuk janë paraqitur dëshmi shtesë në lidhje me arsyet e eliminimit. Andaj, B-42 është plotësisht i qëndrueshëm dhe mbetet në fuqi sipas arsytiveve të dhëna.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 09.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1197, ndërsa me datë 22.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1197, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEValdrini Sh.P.K, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1197 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna Drenas gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar 100,000.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 par 1 dhe 3, 6, 7, 10, 56, 59, 60 69, dhe 72, të LPP-së, si dhe nenin 38.1 , 40.1.2.6 dhe nenin 97.1 (d) dhe (o) të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, dhe nenit 10 të Udhëzuesit nr. 01/2023. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, konkretisht kundër ofertës së OE të rekomanduar për kontratë dhe arsytimit të eliminimit të ankuesit. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, dhe jep përgjigje si në vijim.

Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se AK përmes Letrës standarde për tenderuesit e eliminuar me datën 14.11.2025, e ka eliminuar OE ankues me arsyetimin se nuk i plotëson 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa të dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues ka kundërshtuar arsyetimin e AK përmes kërkesës për rishqyrtim por AK përmes vendimit të datës 24.11.2025, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të GOE ankues si të pa bazuar.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues pretendon se sipas kërkesës së AK në DT ka qenë: Afatet kohore për fillimin dhe /ose përfundimin e kontratës: Plani dinamik 30 ditë. OE ankues potencon se në ditën e ofertimit kanë dorëzuar planin dinamik në të cilin kanë deklaruar se GOE “Valdrini sh.p.k& Benita Company shpk”, këtë projekt mundë ta realizojnë për 30 ditë dhe ky plan dinamik është bërë sipas kërkesës së AK-së në DT.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek pika 5.2 në DT është kërkuar:

Lidhur me këtë kërkesë të AK GOE ankues së bashku me ofertën ka dorëzuar:

11.Aneksi 1,2,Konserciumi,Plani dinamik.pdf

Ekspertja shqyrtuese, pas shqyrtimit dhe analizimit të dosjes së tenderit, sqaron se AK në pikën 5.2 të dosjes së tenderit, të vetmen kërkesë në lidhje me planin dinamik e ka përcaktuar afatin kohor prej 30 ditësh, ndërsa nuk e ka bërë ndarjen e punëve në mënyrë që operatorët ekonomik të përcaktojnë ditët e punëve sipas fazave të kryerjes së punimeve. Për më tepër, AK nuk ka kërkuar asnjë detaj kohor lidhur me fillimin dhe përfundimin e projektit, as ditë pune apo ditë kalendarike, ashtu siç specifikohen në shumë dosje të tenderit. Kurse, OE ka dorëzuar një tabelë të planit dinamik duke shënuar se mund të realizojnë projektin për 30 ditë. Për rrjedhojë një plani i tillë dinamik i prezantuar nga GOE ankues, vlerësoj se është konform kërkesës së AK-së. Pra formulimi i tillë i kërkesës në dosje të tenderit nuk kërkon detaj kohor lidhur me fillimin dhe përfundimin e projektit, andaj arsyetimi eliminimit për këtë pikë është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, në të cilin thuhet:

3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Po ashtu edhe nenin 40.12 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik është përcaktuar: Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se kanë paraqitur menaxherin e projektit ing. Nuri Shabani në liste të stafit të partnerit të konzerciumit Benita Company sh.p.k tek fajlli nr. 10.Lista e stafit ORG, Benita,Vendimi MK.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT është kërkuar:.

1.Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. Stafi i mesëm që do të kyqet në projekt – minimum 6 punonjës, Menaxheri i projektit të jetë inxhinier

I NDERTIMTARISE DREJTIMI KONSTRUKTIV (PERVOJ PUNE MIN 7 VJEQAR PAS DIPLOMIMIT i caktuar me një vendim, Diplomën dhe CV-ija-Te jete i Çertifikuar me ISO 9001-2015 dhe Shëndeti dhe siguria ne pune dhe mbretje nga zjarr. Një Inxhinier I Ndertimtarise – drejtimi hidroteknik me 5 vite përvoje pune

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Lista e stafit - Origjinal-Për punëtorët të ofrohen kontratat dhe për inxh.te ofrohet dëshmi diplom univerzitare ,vendimi i menaxherit të kontratës, cvja dëshmitë e përvojës , kontrata e punës ose marrëveshje me titull të tenderit mes dy palve për projektin konkret dhe certifikata .

Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, GOE ankues së bashku me ofertën, kanë dorëzuar dokumentet si vijon:

13.Nuri Shabani-Inxhinier Konstruktiv.pdf, dhe

10.Lista e stafit ORG,Benita,Vendimi MK.pdf, në të cilat dokumentet janë prezantuar dëshmitë si në vijim: diploma, vendimi i menaxherit të kontratës, kontrata e punës, lista e stafit, referencat, cv, certifikatat etj. Andaj pretendimi i GOE ankues është i bazuar edhe në këtë pikë.

Pretendimi ankimor 3: GOE ankues pretendon se ka paraqitur një kamion special i cili shërben për shpërndarjen e emulsionit dhe e kryen të njëjtin funksion sipas kërkesës së AK, si dëshmi kanë ofruar fotot dhe po ashtu kamioni është makine mobile potencon ankuesi.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT tek pika 14 është kërkuar:

14.Makinë për spërkatje të emulzionit – mobile

Dëshmia e kërkuar dokumentare

8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka në pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera . Marreveshje me një kompani ose baze asfalti dhe zhavori me license valide

Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, GOE ankues së bashku me ofertën, ka dorëzuar dokumentin si vijon: “24.Paisje me qera ABC.pdf,” në të cilin dokument janë paraqitur dëshmitë si: Kontrata mbi dhënie dhe marrjen e mjeteve me qira për 3 (tri) pajisje, në mesin e të cilave është specifikuar edhe Makina për spërkatje të emulzionit – mobile. GOE në lidhje me këtë pajisje ka dorëzuar librezën e regjistrimit me nr. CRA 2218190 me nr. të targave 01-964-CV, me përshkrim “Kamion Special me dy dyer”, duke i bashkangjitur edhe 2 fotografi të pajisjes në fjalë. Ekspertja shqyrtuese konsideron se arsyetimi i AK-së “... në librezë nuk shkruan për integrim në kamion të makinës spërkatëse të emulsionit”, për vlerësimin e ekspertës shqyrtuese është arsyetim i pamjaftueshëm sepse është dashur që gjatë vlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime nga GOE ankues sipas nenit 59 të LPP-së dhe të marr përgjigje konkrete pse kjo pajisje nuk e plotëson kërkesën e AK-së.

Pretendimi ankimor 4: OE ankues pretendon se ka paraqitur pajisjen Cilinder me xhemba, vibratorë dhe shtytës max.700kg, e cila pajisje plotëson kërkesën e AK-së, AK nëse kanë pas dilema është dashur të kërkojnë sqarime shtese potencon ankuesi sepse për këtë pajisje kemi

ofruar edhe dudin doganor i cili dëshmon edhe me shumë që kjo pajisje është sipas kërkesës së AK-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT tek pika 6 është kërkuar:

6.Cilindër vibrues me xhamba dhe shtytës, pesha max 700 kg.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytezimin e tyre me qera . Marreveshje me një kompani ose baze asfalti dhe zhavori me license valide

Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, GOE ankues së bashku me ofertën, ka dorëzuar dokumentin me titull: “18.Paisje me qera Shkemb.pdf”, në të cilët dokument janë paraqitur dëshmitë, si: Kontrata mbi dhënien dhe marrjen e mjeteve me qira, në mesin e të cilave pajisje është specifikuar edhe pajisja Cilindër vibrues me xhamba dhe shtytës, pesha max 700 kg, fatura e blerjes në të cilën jepet përshkrimi i pajisjes “Rul me xhamba, vibrator shtytës (marka BOMAG, Tipi BË 75E, Nr. Serik 140119547, pesha 485kg”. Gjithashtu, OE ankues me rastin e parashtrimit të ankesës ka bashkangjitur edhe DUD-in doganor, në të cilin jepet përshkrimi “Rul për shtrimin e rrugëve me xhamba vibrues dhe shtytës (i përforcuar), Marka Bomag, tipi BË 75E, Serial Nr. 140119547”. Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në kërkesë të DT-së pragon maksimal të peshës e ka caktuar 700kg, kurse pesha e mjetit është 485kg që është brenda kufizimit prej 700kg, si dhe DUD-i doganor vërteton se kjo pajisje është me xhamba dhe vibrator shtytës. Pra, AK është dashur që të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59 të LPP-së. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Provë dudi doganor:

Pretendimi ankimor 5: OE ankues pretendon se ka paraqitur pajisjen Traktor 4x4 me lugë ngarkuese dhe lopatë rrafshuese, e cila pajisje plotëson kërkesën e AK-së. OE ankues potencon se nëse AK ka pas dilema, është dashur të kërkojnë sqarime shtesë sepse pajisja e kërkuar në DT është e njëjtë me pajisjen e ofruar nga ne. OE ankues ka bashkangjitur dëshmi shtesë, i cili potencon se e plotëson kërkesën e AK-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT tek pika 13 është kërkuar:

13.Traktor 4x4 me lugë ngarkuese dhe lopata rrafshuese

Dëshmia e kërkuar dokumentare

8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytezimin e tyre me qera . Marreveshje me një kompani ose baze asfalti dhe zhavori me license valide

Ekspertja shqyrtuese sqaron se lidhur me këtë kërkesë të AK-së, GOE ankues së bashku me ofertën, ka dorëzuar dokumentin si vijon: “18.Paisje me qera Shkemb.pdf”, në të cilat dokumente

janë paraqitur dëshmitë, si: Kontrata mbi dhënien dhe marrjen e mjeteve me qira, në mesin e të cilave pajisje, është specifikuar edhe pajisja Traktor 4x4 me lugë ngarkuese dhe lopata rrafshuese.

Ekspertja shqyrtues sqaron se OE ankues së bashku me ofertë ka dorëzuar edhe dëshmi për këtë pajisje dhe pajisje tjera por shumica e dokumente janë të kualitetit shumë të dobët dhe është e pamundur të identifikohen. Andaj, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues dhe të verifikoj nëse kjo pajisje e plotëson kërkesën e AK-së meqenëse në faturën e shit-blerjes ceket edhe numri i shasisë.

Pretendimi ankimor 6: OE ankues pretendon se ka paraqitur pajisjen Greder me ripera dhe ndalesa zhavori me peshë 16,000 kg (16 ton), me librezë qarkullimi valide dhe me foto të cilat dëshmojnë se është sipas kërkesës së AK-së, si dhe marrëveshjen me qera nga Kthella sh.p.k. potencon ankuesi.

Përgjigje në pretendimin ankimor 6: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT tek pika 7 është kërkuar:

7. Makineri sheshuese dhe nivelizuese– Grejder me ripera dhe ndalesa të zhavorit, pesha min.16-max.18ton.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera . Marreveshje me një kompani ose baze asfalti dhe zhavori me license valide.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se lidhur me këtë kërkesë të AK-së, GOE ankues së bashku me ofertën, ka dorëzuar dokumentin me titull: “19.Paisje me qera Kthella.pdf”, në të cilët dokument janë paraqitur dëshmitë, si: Kontrata mbi dhënien dhe marrjen e mjeteve me qira, librezë qarkullimi valide me nr. LAD0430017, Nr. Të targave ABMT15, Certifikata e kontrollit teknik të mjetit dhe tri fotografi. Meqenëse në certifikatën e kontrollit teknik dhe librezën e qarkullimit nuk ceket numri i modelit, nuk mund të konstatohet nëse OE e plotëson apo nuk e plotëson këtë kërkesë. Andaj, ekspertja shqyrtues vlerëson se AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59 të LPP-së edhe për këtë pajisje pasi që në bazë të dëshmive dihet numri i shasisë.

Pretendimi ankimor 7: OE ankues pretendon se ka paraqitur pajisjen Cift semafora mobil me dirigjues digjital të marrë me qira nga OE “Ndertimi ing shpk”, ku dëshmohet se janë dy copa sinjalizues elektrik të trafikut (2 semafor me bateri) dhe dudin doganor të tyre. OE ankues shton se ka prezantuar edhe dy semafora (çifte) me marrëveshje me qira nga OE “Alko “Impex Construction” të dëshmuar me fatura blerje.

Përgjigje në pretendimin ankimor 7: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT tek pika 15 është kërkuar:

15.Cift semafora mobil për komunikacion me dirigjues digjital

Dëshmia e kërkuar dokumentare

8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka në pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera . Marreveshje me një kompani ose baze asfalti dhe zhavori me license valide

Ekspertja shqyrtuese lidhur me këtë kërkesë të AK-së sqaron se GOE ankues së bashku me ofertën, ka dorëzuar dokumentet: “22.Paisje me qera Ndertimi.pdf” dhe ”26.Paisje me qera ALKO.pdf”, ku tek dokumenti “22.Paisje me qera Ndertimi.pdf” është prezantuar Kontrata mbi dhënien dhe marrjen e mjeteve me qira për pajisjen Cift semafora mobil për komunikacion me dirigjues digjital, si dhe fatura e blerjes. Në këtë faturë të blerjes, të lëshuar nga shitësi “N.N.T. MORINA-AM”, jepet përshkrimi i mallit “sinjalizuese elektrik të trafikut që përdorën gjatë punimeve në rrugë për rregullimin e komunikacionit. Semafora me bateri të përdorura, sasia 2 copë”. I njëjti përshkrim jepet edhe në DUD-in doganor. Ndërsa tek dokumenti “26.Paisje me qera ALKO.pdf” është prezantuar Kontrata mbi dhënien dhe marrjen e mjeteve me qera, për pajisjen Cift semafora mobil për komunikacion me dirigjues digjital si dhe fatura e blerjes. Meqenëse në dëshmitë e dorëzuara tek dokumenti me titull “22.Paisje me qera Ndertimi.pdf”, jepen informata se janë semafor me bateri, ekspertja shqyrtues konsideron se në bazë të përshkrimit të kërkesë së AK, kjo pajisje plotëson kërkesën e AK-së. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor 8: OE ankues pretendon se ka paraqitur pajisjen Kamion kiper me vinç me peshë bartëse 8-9 ton me sistem për ruajtjen të nxehtësisë, e cila pajisje plotëson kërkesën e AK-së, AK nëse kanë pas dilema është dashur të kërkojnë sqarime shtese potencon ankuesi sepse për këtë pajisje kemi ofruar marrëveshjen me qira nga OE “Kabashi projektim ndërtim shpk”.

Përgjigje në pretendimin ankimor 8: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT tek pika 10 është kërkuar:

10.Kamion kiper me vinc për transport dhe sistem për ruajtjen e nxehtësisë së asfaltit, pesha maksimale e ngarkesës së lejuar min.8ton-9ton.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka në pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera . Marreveshje me një kompani ose baze asfalti dhe zhavori me license valide

Ekspertja shqyrtuese sqaron se lidhur me këtë kërkesë të AK-së, GOE ankues së bashku me ofertën, ka dorëzuar dokumentet: “23.Paisje me qera Fidani Beton,Fidani L,Kabashi.pdf” në të cilin dokument është paraqitur Kontrata mbi dhënien dhe marrjen e mjeteve me qira të pajisjes, si dhe librezë e regjistrimit të këtij mjeti (pajisje), ku në këtë marrëveshje ceket pajisja “Një kamion kiper me vinç për transport dhe sistem për ruajtjen e nxehtësisë së asfaltit me peshë maksimale të ngarkesës së lejuar 8 ton – 9 ton”. Si dëshmi ka bashkangjitur edhe librezën e regjistrimit me nr. të targave 03-436GQ. Në këtë librezë të regjistrimit, pesha maksimale e ngarkesës së lejuar është 8290kg, kurse përshkrimi i mjetit është kiper me vinç me 2 dyer. Mirëpo në librezë nuk ceket sistemi për ruajtjen e asfaltit. Andaj, ekspertja shqyrtuese nuk mund të konstatoj nëse ky mjet ka edhe funksionin e ruajtjes së nxehtësisë së asfaltit. AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59 të LPP-së, edhe për këtë pajisje.

Pretendimi ankimor 9: OE ankues pretendon se ka paraqitur pajisjen Eskavator me dy kova rrafshuese dhe ngarkuese 15-16 ton, të marrë me qira nga OE “Kabashi projektim ndërtim shpk”.

ku dëshmohet me dud doganor eskavator me 1+3 lug ngarkuese dhe me foto, ku dëshmon se ka një kove për ngarkim dhe një lopatë rrafshuese para, po ashtu i njëjtit ka edhe dy kova tjera shtesë, të cilat ndërrohen sipas nevojës. OE ankues potencon se ka edhe një ekskavator shtesë që plotëson kërkesën e AK-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 9: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT tek pika 3 është kërkuar:

3.Eskavator me dy kova rrafshuese dhe ngarkuese pesha min. 15 – max.16 ton.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera . Marreveshje me një kompani ose baze asfalti dhe zhavori me license valide

Ekspertja shqyrtuese sqaron se lidhur me këtë kërkesë të AK-së, GOE ankues së bashku me ofertën, ka dorëzuar dokumentet si vijon: “23.Paisje me qera Fidani Beton,Fidani L,Kabashi.pdf” në të cilin dokument është paraqitur Kontrata mbi dhënie dhe marrjen e mjeteve me qira të pajisjes, dudi doganor dhe foto. Sipas përshkrimit të dhënë në DUD-in doganor, bëhet fjalë për pajisjen “eskavator 1+3 lugë ngarkuese”, kurse AK në arsyetimin e dhënë për eliminim të OE ankues, konstaton se është me një lugë ngarkuese. Andaj, duke pasur parasysh DUD-in doganor në të cilin ceket “1+3 lugë ngarkuese”, ekspertja shqyrtues vlerëson se AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, është dashur të kërkoj sqarime lidhur me këtë pajisje nëse ka pas dilema, pasi që është prezantuar marrëveshja e mjeteve me qira dhe dudi doganor me përshkrim të pajisjes. Kërkimi i sqarimeve shtesë është i lejuar edhe në nenin 10 të rregullores.

Pretendimi ankimor 10: OE ankues pretendon se ka paraqitur pajisjen Pompe zhytëse për largimin e ujërave me kapacitet 7.5-11W, modeli Altas CopcoWED 7.5 KW, sipas faturës së blerjes, e cila është në pronësi të liderit të grupit Valdrini shpk dhe është sipas kërkesës se AK potencon ankuesi, pasi që kërkesa e AK për kapacitet ka qen 7.5 deri 11 Kw, në fakturë ceket kapacitet i pompës 7.5 KW.

Përgjigje në pretendimin ankimor 10: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT tek pika 16 është kërkuar:

16.Pompë zhytëse për largimin e ujërave me fuqi 7.5kw-11kw.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera . Marreveshje me një kompani ose baze asfalti dhe zhavori me license valide

Ekspertja shqyrtuese sqaron se lidhur me këtë kërkesë të AK-së, GOE ankues së bashku me ofertën, ka dorëzuar dokumentin si vijon: “3.PAISJET VALDRINI SHPK 2025.pdf” në të cilin dokument është paraqitur pajisja që është në pronësi të OE Valdrini shpk, konkretisht tek numri rendor 40.

Po ashtu për ket paisje është dorzuar dhe fatura e shitjes.

Ekspertja shqyrtues sqaron se AK ka potencuar “...në faturë nuk është e shkruar fuqia, ndërsa bazuar në të dhënat e pompës që keni paraqitur fuqia e kësaj pompe është shumë here më e vogël.”

Ekspertja shqyrtues bazuar në dokumentet e bashkangjitura të GOE ankues, vlerëson se pretendimi i AK-së nuk është i bazuar pasi që në faturë është e specifikuar fuqia e pajisjes 7.5 kw dhe tek pozicioni numër 40 tek lista e pajisjeve ceket fuqia e pajisjes 7.5kw. Pra, kjo pajisje është brenda limiteve të përcaktuara të AK-së në dosje të tenderit prej 7.5kw deri 11kë.

Pretendimi ankimor 11: OE ankues pretendon se ka paraqitur pajisjen Kompresor ajri me sistem elektrik dhe agregat min 320 volt, e cila është në pronësi të lideri të grupit Valdrini shpk dhe një Agregat min 320 vol e cila është në pronësi të partnerit të grupit Benita Company shpk, të cilat pajisje plotësojnë kërkesës se AK potencon ankuesi, këto pajisje janë të dëshmuar tek fajlli 27.

Përgjigje në pretendimin ankimor 11: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat e 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: në DT tek pika 18 është kërkuar:

18.Kompresor ajri me sistem elektrik dhe agregat min. 320 volt.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

8.Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje dëshmi (kopjet e librezave - valide , fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera . Marreveshje me një kompani ose baze asfalti dhe zhavori me license valide

Ekspertja shqyrtuese sqaron se lidhur me këtë kërkesë të AK-së, GOE ankues së bashku me ofertën, ka dorëzuar dokumentin si vijon: “3.PAISJET VALDRINI SHPK 2025.pdf”, 14.Paisjet me qera Benita Company 2025.pdf, 27.Aneksi për paisje sipas kerkesave te AK.pdf dhe dokumentin “3.PAISJET VALDRINI SHPK 2025.pdf”, ekspertja shqyrtues sqaron se në dokumentin “3.PAISJET VALDRINI SHPK 2025.pdf”, pozicioni nr. 35 gjendet pajisja me titull “kompresor Yato”, gjithashtu tek dokumenti “27.Aneksi për pajisjen sipas kërkesave te AK.pdf”, është cekur emri i kësaj pajisje në pronësi të liderit të grupit “Valdrini shpk”

Meqenëse në listën e pajisjeve dhe faturën e bashkangjitur më poshtë si provë, gjendet kompresori, ekspertja shqyrtues vlerëson se AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime lidhur me këtë pajisje pasi që është prezantuar tek dokumentet e cekura si më lartë. Ndërsa, sa i për ketë dokumentit “14.Paisjet me qera Benita Company 2025.pdf” janë prezantuar tre Gjenerator dhe dy kompresor ajri.

Në mbështetje të asaj që është cekur si më lartë, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë GOE ankues konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, ndonëse GOE ankues ka dorëzuar me tender disa nga dëshmitë për pajisje, por jo të gjitha dëshmitë e nevojshme për të

arritur në konstatime përfundimtare. Andaj, AK gjatë ri-vlerësimit mundet të kërkoj sqarime për pajisje por duke u siguruar që ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet, ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive ashtu siç parashikohet në nenin 72.3 të LPP-së. Për rrjedhojë, rekomandohet që lënda të kthehet në rivlerësim dhe që vlerësimi i ofertave të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, duke respektuar parimet e trajtimit të barabartë konform nenit 7 të LPP-së. Njëkohësisht, rekomandohet që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i rrugës Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës, Drenas me numër të prokurimit 611-25-9865-5-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ja fal besimin raportit të ekspertit shqyrtues, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA GLLOGOC**
- **OE - Valdrini sh.p.k**
- Arkivës së OSHP-së: